



Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2018, merr këtë:

V E N D I M

PËR ORIENTIMIN E TË HYRAVE VETANAKE TË VITIT 2017 TË BARTURA NË VITIN BUXHETOR 2018

I.

Orientohen mjetet nga të hyrat vetanake të vitit 2017 të bartura në vitin buxhetor 2018, në shumën prej **111,269.74 €**, si në pasqyrën e paraqitur më poshtë:

Kategoria ekonomike, Paga dhe medetje:

1. Kujdesi Primar Shëndetësor- kodit (73900) me kod funksional(0721).....shuma prej 14,213.13 €, pagesa e kujdestarive të natës.

Kategoria ekonomike, Subvencione dhe transfere:

1.Zyra e Kryetarit-kodi (16015) me kod funksional (0111).....shuma prej 20,000.00 €,për subvencionimin e garave të skijimit "Kupa e Gjeravicës 2018" që do të mbahet në bjeshkën e Belegut.

Kategoria ekonomike, Shpenzimet Kapitale:

1. Sherbime Publike - Infrastruktura rrugore-kodi (18015), me kod funksional (0451) , Projekt i Ri "Shpronësimi i pronave private", shuma prej 77,056.61 €.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: - Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për MSH dhe SHP, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të KK Deçan.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, MAPL, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për MSH dhe SHP, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.II-3

Deçan,dt.28.02.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj

